



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr: 98

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 9, DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

OBJEKT: Përdorimi i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 8019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 10.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 9 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Drejtuesit politik të Partisë Socialiste kanë shkuar në Greqi dhe Itali për t’u takuar me emigrantët. Dyshimi jonë dhe i shoqërisë civile konsiston se drejtuesit politik të Partisë Socialiste gjatë takimeve të tyre janë duke shpërdoruar burimet publike, në forma të ndryshme, për të ndikuar emigrantët në zgjedhje”.

Data: 14.02.2025

Nr: 98
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 9, datë 10.02.2025 të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 8019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI